



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 375 Akti

Nr. 302 Vendimi
Tiranë, më 2.10.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesues
Olsi Komici	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 30.9.2020, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Erjon Çela**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Çela, vëzhguesen ndërkombëtare, zj. Elka Ermenkova, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Erjon Çela, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Subjekti i rivlerësimit iu është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. 1, datë 16.12.2019 trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Erjon Çela, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi si kryesues të trupit gjykues komisioneren Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar, znj. Elka Ermenkova.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe grupi i punës në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 18.9.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Çela, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 18.9.2020 mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur

me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike në datën 28.9.2020.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 30.9.2020, ora 13:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, parashtrroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë trupit gjykues.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Erjon Çela ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Çela, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Me shkresën nr. ***, datë 28.2.2019, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Çela, i cili është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2011, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2011 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 25.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1¹, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

➤ Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”

1. Apartament me sip. 90.21 m², ndodhur në *, Tiranë, i blerë në datën 15.5.2015, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., në shumën 59,862 euro. Pjesa takuese: 100% (aktualisht kjo pasuri është hipotekuar në favor të “Union Bank” sipas kontratës së hipotekës, datë 28.5.2015).**

Burimi i krijimit: (a) shuma prej 48,000 euro e marrë kredi në datën 22.5.2015 në “Union Bank” sipas kontratës së kredisë bankare²; (b) shuma 11,885 euro marrë hua shtetases F.H., (halla e subjektit) sipas kontratës së huas, datë 10.4.2015³.

Subjekti ka depozituar:

- *certifikatë për vërtetim pronësie për apartamentin me sip. 90.21m², lëshuar në datën 19.5.2015, me adresë ***, Tiranë me nr. pasurie ***, vol. ***, f.***. dhe kartela përkatëse e pasurisë;*
- *kontratë shitblerje pasurie të paluajshme me kusht kreditimi, datë 15.5.2015⁴, me shitës M.B., dhënëse e pëlqimit V.B., dhe blerës Erjon Çela për apartamentin me sip. 90.21 m² me adresë ***, Tiranë, për çmimin 59,862 euro;*
- *mandatpagesë e lëshuar nga BKT-ja ku në datën 10.4.2015, shtetasi Erjon Çela ka kaluar në llogari të shitësit M.B., (person fizik) shumën 12,000 euro me përshkrim “kalim fondesh për blerje apartamenti).*

Në kontratën e shitblerjes përcaktohet likuidimi i çmimit, si vijon: “ ... kësti i I-rë në shumën 12,000 euro nga ana e blerësit është likuiduar në llogari të shitësit. Diferenca e çmimit në shumën 47,862 euro nga do t’i likuidohet shitësit me kredi bankare nëpërmjet “Union Bank”. Dorëzimi i pasurisë do të bëhet në momentin kur shitësi do të likuidohet nga blerësi për çmimin e pa paguar në shumën 47,862 euro ”.

Në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2015 subjekti ka deklaruar: “*Apartament me sip. 90.21 m², i ndodhur në ***, Tiranë i blerë në datën 15.5.2015 sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr.*** kol., në shumën 59,862 euro. Burimi i krijimit: shuma e marrë kredi në “Union Bank” dhe hua e shtetases F.K.*”.

ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, ka konfirmuar regjistrimin e pasurisë me të dhënat, si më sipër, në emër të z. Erjon Çela.

Komisioni ka verifikuar çmimin e blerjes së apartamentit duke e krahasuar atë me çmimet referuese të EKB-së dhe sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave të vitit 2015⁵ ka rezultuar se

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

² Kontrata e kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.5.2015.

³ Kontrata e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.4.2015.

⁴ Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol.

⁵ Udhëzimi nr.***, datë 30.09.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2015”.

vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2015 për qytetin e Tiranës në zonën 6 që përfshihet edhe zona e *** është 65,000 lekë/m².

Duke llogaritur sipërfaqjen 90.21m² x 65,000 lekë/m² çmimi i këtij apartamenti sipas referencave të EKB-së do të ishte në shumën 5,863,650 lekë ose 41,577 euro (sipas kursit ditor të llogaritur 141.03 lekë/euro).

- Komisioni nuk konstatoi problematikë në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, krahasuar me çmimet e referencës të përcaktuara me udhëzimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Komisioni ka hetuar edhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasit M., dhe V.B., duke kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Tropojë ku subjekti Erjon Çela ka ushtruar detyrën e gjyqtarit.

Nga hetimi i kryer, Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e përcjellë prej tij dhe nga ASHK-ja Tiranë.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me mënyrën e përfitimit të pronësisë mbi apartamentin nga subjekti, si dhe vlerës së tij.

Nuk është konstatuar ndonjë situatë konflikti interesi e subjektit të rivlerësimit me shtetasit M., dhe V.B., gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

➔ **Në lidhje me burimin e krijimit**

Burimi i I-rë – shuma prej 48,000 euro e marrë kredi në datën 22.5.2015 në “Union Bank” sipas kontratës së kredisë bankare.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Kredi për blerje apartament banimi në ***, Tiranë, në shumën 48,000 euro...me afat 25 vjet...”*.

Subjekti ka depozituar:

- kontratën e kredisë bankare, datë 22.5.2015⁶, të lidhur ndërmjet “Union Bank” dhe shtetasve Erjon Çela, A.Ç., dhe K.Sh., për marrjen e kredisë në shumën 48,000 euro me afat shlyerje 25 vjet;
- kontratë hipotekimi e bankës me shtetasin M.B., mbi apartamentin me sip. 90.21 m²;
- kontratën e hipotekës, datë 28.5.2015⁷, lidhur me “Union Bank” dhe shtetasin Erjon Çela për vënien e hipotekës në favor të bankës mbi pasurinë “apartament” me sip. 90.21 m² me adresë ***, Tiranë, për të garantuar shlyerjen e kësaj kredie.

Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me kredinë e marrë në Union Bank.

Burimi i II-të – shuma 11,885 euro marrë hua shtetasës F.K., (halla ime) sipas kontratës së huas datë 10.4.2015⁸.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Hua e marrë nga shtetasja F.K., për blerje apartamenti i ndodhur në ***, Tiranë, në shumën 11,885 euro, pa*

⁶ Kontratë krdise bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.5.2015.

⁷ Kontratë e hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2015.

⁸ Kontratë e huas nr. *** rep. nr. *** kol., datë 10.4.2015.

*interes me afat 10-vjeçar. Fillon në datën 10.4.2015 dhe mbaron në datën 10.4.2025 sipas kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.4.2015”.*

Subjekti ka depozituar:

- *kontratë huaje, datë 10.4.2015, me huadhënës F.K., dhe huamarrës Erjon Çela;*
- *dokument bankar lëshuar nga BKT-ja, datë 10.4.2015, F.K., transferon në llogari të Erjon Çela shumën 11,885 euro me përshkrimin “dhënie huaje”.*

Gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar se nga shuma e marrë hua 11,885 euro, i ka likuiduar shtetases F.K., shumën prej 3,000 euro në datën 23.12.2019, sipas mandatpagesës së lëshuar nga BKT-ja, datë 23.12.2019.

Në lidhje me burimin e të ardhurave të shtetases F.K., subjekti ka deklaruar se kjo shumë i është dhënë nga: (i) kursimet e saj nga paga si specialiste buxheti pranë ZABGJ-së; dhe (ii) të ardhurat e përfituara nga qiraja e marrë për një apartament të ndodhur në ***, Tiranë.

Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat që kanë krijuar shumën 11,885 euro të shtetases F.K.: *nxjerrje llogarie nga “Credins Bank” që pasqyron llogarinë e pagës së saj, si dhe pagesat e qirasë që bëhen në këtë llogari nga shetasi E.V., në shumën 32,000 lekë.*

Nga nxjerrja e llogarisë bankare në “Credins Bank” në emër të shtetases F.K., rezulton se për periudhën 8.1.2014 – 3.4.2015 janë kredituar në llogari 512,000 lekë nga shetasi E.V., si pagesa mujore qiraje në shumën 32,000 lekë. Në këtë llogari janë pasqyruar edhe të ardhurat e përfituara nga znj. F.K., nga paga si specialiste buxheti pranë ZABGJ-së për periudhën janar – shtator 2014, në shumën 567,723 lekë.

Komisioni i ka kërkuar subjektit:

- të specifikojë sa janë të ardhurat nga qiraja dhe sa nga kursimet nga pagat në shumën 11,885 euro;
- të depozitojë kontratën e qirasë dhe të provojë pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja, nga znj. F.K.

Subjekti ka shpjeguar se: *“...në gjendjen e llogarise (dokumenti - statement), rezulton se në llogarinë e saj në ‘Credins Bank’ ka derdhje nga paga (si punonjëse pranë ZABGJ-së) dhe pagesa qeraje (nga shetasi E.V., për apartamentin e marre me qera i ndodhur në, Tiranë)”.*

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale⁹, datë 20.6.2020, në të cilën znj. F.K., deklaron se: *“...burimi i krijimit të shumës prej 11,885 euro janë kursimet e krijuara, ndër vite, nga paga si punonjëse specialiste buxheti pranë Zyrës së Administrimit Gjyqësor, si dhe të ardhura të krijuara nga dhënia me qira e një apartamenti në pronësinë time në qytetin e Tiranës. Shuma prej 11,885 euro e cila i është dhënë hua shtetasit Erjon Çela përbëhet: 98 % e saj janë kursime të krijuara nga paga ndër vite dhe vetëm 2% e saj janë të ardhura të përfituara nga qiraja”.*

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga qiraja e apartamentit sqaroj se me shtetasin E.V.(qiramarrësi) kemi pasur një kontratë të përpiluar me shkrim dore në vitin 2013 të cilën aktualisht nuk e disponoj. Kjo për shkak se ky shtetas nuk është më qiramarrës i apartamentit

⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë.20.6.2020.

dhe nuk kam asnjë kontakt me të. Për sa i përket pagimit të tatimit mbi të ardhurat nga qiraja, të gjitha pagesat e qirasë nga qiramarrësi janë kryer në mënyrë periodike në çdo fillim muaji nëpërmjet bankës, në llogarinë time bankare me përshkrimin: për pagesë qiraje. Nuk kam dijeni nëse ky tatim në burim është mbajtur nga banka ose jo”.

Subjekti, si dokumentacion provues për të ardhurat nga paga që kanë krijuar shumën 11,885 euro të shtetases F.K., ka depozituar:

- *vërtetim për bazën e vlerësueshme neto dhe pagën neto mesatare, nga Zyra Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për periudhën 2000 – 2015.*

Viti	Të ardhura nga pagat ZABGJ	Shpenzime jetike	Mundësia për kursime
2000	262,043	93,864	168,179
2001	347,280	93,864	253,416
2002	439,314	93,864	345,450
2003	524,244	93,864	430,380
2004	539,071	93,864	445,207
2005	545,255	109,557	435,698
2006	560,957	109,557	451,400
2007	589,042	136,620	452,422
2008	619,518	136,620	482,898
2009	653,064	136,620	516,444
2010	611,936	136,620	475,316
2011	689,667	136,620	553,047
2012	709,426	141,024	568,402
2013	732,685	141,024	591,661
2014	758,056	219,998	538,058
2015	63,024	18,690	44,334
Total	8,644,582	1,892,270	6,752,312

Me të ardhurat totale nga pagat në shumën 8,644,582 lekë, personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka mbuluar shpenzimet jetike duke pasur mundësi të kursejë shumën totale prej 6,752,312 lekësh, shumë kjo e cila është e mjaftueshme si burim krijimi për huan në shumën 11,885 euro. Shpenzimet jetike për personin tjetër të lidhur janë llogaritur për 1 person, pavarësisht përbërjes familjare të saj e cila rezulton të jetë me 4 anëtarë.

Nga verifikimi i faqes zyrtare *online* të QKB-së, rezulton se zj. F.K., nga data 18.1.2016 është administratore e shoqërisë “***” sh.p.k.

Me vendimin¹⁰ për lëshim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore, përcaktohet se trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të të ndjerit M.K., (ish-bashkëshorti) janë shtetasit F., L., dhe B.K., të cilët trashëgojnë nga 33.33 % të kapitalit të shoqërisë “***” sh.p.k. Kjo shoqëri është themeluar më 25.9.1996 me ortakë M.K., dhe M.D..

Me vendimin e datës 8.12.2012 të Asamblesë së Përgjithshme, ortaku M.K., blen 50 % të pjesës që zotëron ortaku M.D., duke u bërë kështu ortak i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k. Nga pasqyrat financiare të shoqërisë “***” sh.p.k. rezulton se në vitin 2014 është shpërndarë dividend në shumën 2,500,000 lekë, ndërsa në vitin 2015 është shpërndarë dividend në shumën 4,300,000 lekë.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 11,885 euro nga znj. F.K., nga llogaritja e pagave rezulton se nga viti 2000 – 31.01.2015, ka përfituar në total shumën 8,644,582 lekë.

Për të ardhurat e përfituara nga qiraja që përbëjnë 2 % të shumës 11,885 euro, nuk provohet nëse është paguar tatimi mbi të ardhurat, pavarësisht se pagesa e qirasë mujore është bërë me bankë, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë në analizën e kryer nga Komisioni, si burim i ligjshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së ka rezultuar se në periudhën e dhënies së huas i ndjeri bashkëshorti i znj. F.K., ka qenë ortak i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k. dhe në vitet 2014 dhe 2015 kjo shoqëri ka shpërndarë dividend në shumën 2,500,000 lekë dhe 4,300,000 lekë.

Në përfundim të hetimit të kryer nga Komisioni, rezultoi se personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, shtetasja F.K., (halla e subjektit), në cilësinë e huadhënëses, ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme, për dhënien e huas në shumën 11,885 euro, subjektit të rivlerësimit.

2. Autoveturë “Peugeot tip 206”, blerë në datën 30.1.2015, sipas kontratës së shitblerjes, datë 30.1.2015,¹¹ me vlerë 500 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara nga paga si gjyqtar.

Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së mjetit, datë 30.1.2015¹², me shitës F.A., dhe blerës Erjon Çela për çmimin 500 euro, paguar shitësit jashtë zyrës noteriale.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2015 subjekti ka deklaruar: *“Autoveturë Peugeot 206 blerë në datën 30.1.2015 sipas kontratës së shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., në shumën 500 euro. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga”*.

DPSHTRr-ja¹³ ka depozituar dosjen e mjetit “Peugeot 206” me targa ***. Mjeti është blerë nga shtetasi F.A., në datën 5.6.2013, në Zvicër, për shumën 1000 FRCH ose 113,560 lekë (konvertuar

¹⁰ Vendim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.1.2016.

¹¹ Kontratë e shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2015.

¹² Kontrata e shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2015.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2020, nga DPSHTRr-ja.

me kursin ditor 113.56 lekë/ch). Për këtë mjet, është paguar taksa doganore nga shtetasi F.A., në datën 22.1.2015, në shumën 29,902 lekë, në total ky mjet ka kushtuar 143,462 lekë.

Automjeti “Peugeot tip 20” është përfituar nga subjekti Erjon Çela me kontratën e shitjes së datës 30.1.2015¹⁴ me shitës F.A., (i përfaqësuar me prokurë nga J.M.) përkundrejt çmimit 500 euro ose 69,860 lekë (konvertuar me kursin 139.72 lekë/euro).

Me kontratën e shitjes së datës 2.5.2017¹⁵ shtetasi Erjon Çela ia ka shitur këtë mjet shtetasit I.B., në shumën 150,000 lekë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Subjekti i rivlerësimit pas dy vitesh përdorimi e ka shitur mjetin me fitim në shumën 80,140 lekë (150,000 - 69,860 lekë).

Në lidhje me burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit (të ardhura nga pagat), Komisioni ka konstatuar që në llogarinë bankare të pagës në “Raiffeisen Bank” janë kryer tërheqjet e mëposhtme në shumën 78,000 lekë të cilat rezultojnë të jenë të mjaftueshme për të paguar çmimin e mjetit prej 500 euro ose 69,860 lekë.

Data e veprimit	Shuma e tërhequr
09/01/2015	-30,000.00
13/01/2015	-18,000.00
13/01/2015	-30,000.00

Komisioni ka hetuar edhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi gjatë ushtrimit të detyrës, ndërmjet subjektit të rivlerësimit me shtetasin F.A., dhe përfaqësuesin e tij J.M., dhe për këtë arsye ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Tropojë¹⁶.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, por nuk ka arritur të provojë pagesën e tatimit mbi diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes, prej 80,140 lekësh, të përfituar nga ky transaksion, me argumentin se nga shitja nuk është realizuar fitim.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Trupi gjykues, pasi analizoi provat nga hetimi administrativ, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton se:

Nga hetimi nuk u konstatua ndonjë situatë konflikti interesi gjatë ushtrimit të detyrës, ndërmjet subjektit të rivlerësimit me shtetasin F.A., dhe përfaqësuesin e tij J.M.

Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë pagesën e tatimit për diferencën e çmimit prej 80,140 lekësh në përputhje me paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Pavarësisht faktit të mos pagimit nga subjekti i rivlerësimit të tatimit mbi shumën e përfituar nga shitja e mjetit prej 80,140 lekësh, Komisioni vlerëson se ky transaksion rezulton të jetë kryer pas depozitimit të deklaratës “Vetting” nga subjekti i rivlerësimit dhe për këtë arsye efekti financiar që prodhon nuk ka ndikim dhe, për rrjedhojë, nuk është pasqyruar në analizën financiare për

¹⁴ Kontratë blerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2015, të mjetit “Peugeot tip 206” nga subjekti.

¹⁵ Kontratë shiblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2017.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë; shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

periudhën e deklarimit, duke e konsideruar përfundimisht si një pasuri të krijuar me burime të ligjshme financiare.

3. Depozitë në “Union Bank”, datë 20.1.2017, në shumën 23.09 euro, me pjesë takuese 100 %.

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga.

“Union Bank”¹⁷ ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje në datën 20.1.2017, në shumën 23.09 euro. Në këtë llogari është bërë disbursimi i kredisë bankare për blerjen e shtëpisë dhe nga kjo llogari bëhen pagesat mujore të kësteve të kredisë.

Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga banka.

4. Gjendje llogarie në “Raiffeisen Bank”, datë 30.1.2017, në shumën 5860.94 lekë, me pjesë takuese 100 %.

Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara nga paga.

“Raiffeisen Bank”¹⁸ ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje në datën 30.1.2017 në shumën -134,266.77 lekë, pasi subjekti i rivlerësimit ka pasur të aktivizuar overdraft me limit 140,000 lekë.

Në këtë llogari janë kredituar kryesisht pagat e subjektit, por konstatohen edhe veprime të tjera bankare si marrja e kredisë konsumatore me vlerë 765,000 lekë, në datën 4.6.2015, si dhe marrja hua nga shtetasi E.B., të shumës 420,000 lekë për blerje apartamenti në datën 14.4.2015.

Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga banka.

5. Gjendje cash, në shumën 80,000 lekë, me pjesë takuese 100 %.

Burimi i krijimit: të ardhura familjare të krijuara nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2015 subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash 100,000 lekë. Burimi i krijimit të ardhura të krijuara nga paga*”.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2016 subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash 80,000 lekë. Burimi i krijimit të ardhura të krijuara nga paga ime si gjyqtar dhe paga e bashkëshortes si sekretare gjyqësore*”.

Në fund të vitit 2015, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur likuiditete në shumën – 195,726 lekë (cash dhe bankë), kurse në fund të vitit 2016 kanë pasur likuiditete cash në shumën 80,000 lekë dhe likuiditete në bankë në shumën 212,862 lekë, duke rezultuar me shtesë likuiditetesh për vitin 2016 në shumën 488,588 lekë.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2020, nga “Union Bank”.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

Përshkrimi	2016
Të ardhurat	1,606,127
Të ardhura nga paga në gjykatë	1,113,005
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	357,502
Të ardhura nga leja e lindjes	135,620
Detyrime	-
Shpenzime	1,293,206
Shpenzime jetike	568,139
Shpenzime intersi kartë krediti	19,078
Shpenzime kredie RBAL	164,595
Shpenzime kredie Union	486,394
Shpenzime udhëtimi Tropojë	55,000
Pasuri	454,054
Ndryshim likuiditete (shtesa/pakësime)	454,054
Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri	-141,133

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme financiare për pagimin e shpenzimeve dhe krijimin e likuiditeteve, ndër të cilat, edhe gjendjen *cash* prej 80,000 lekësh, duke rezultuar me balancë financiare negative në shumën 141,133 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet, si vijon:

“Së pari, referuar tabelës e cila pasqyron analizën financiare të vitit 2016 vërehet se nga e Komisioni është llogaritur në zërin e shpenzimeve jetike edhe shuma prej 568,139 lekësh. Në këtë shumë janë përfshirë shpenzimet jetike për dy anëtarë në periudhën 1.1.2016 – 31.7.2016 (në përbërje familjare është Erjon Çela, K.Ç.), ndërsa nga muaji gusht deri në 31 dhjetor 2016 janë shpenzimet jetike janë llogaritur për tre anëtarë (në përbërje familjare është Erjon Çela, K.Ç., S.Ç.). Konstatohet se këto shpenzime jetike janë llogaritur gabim në shumën 568,139 lekë, pasi referuar të dhënave që disponoj rezulton se shpenzimet jetike për vitin 2016 sipas tabelës së INSTAT janë si mëposhtë; (i) për një familje me dy anëtarë janë në shumën 448,552 lekë/vit; (ii) për një familje me tre anëtarë janë 67,2828 lekë/vit. Duke u bazuar në të dhënat sa më sipër, del se për periudhën 1.1.2016 - 31.7.2016 (përbërje familjare me dy anëtarë) shpenzimet jetike duhet të jenë në shumën 261,655 lekë, ndërsa për periudhën 1.8.2016 deri në datën 31.12.2016 (përbërje familjare me tre anëtarë) shpenzimet jetike duhet të jenë në shumën 280,345 lekë. Nga kjo llogaritje del se për vitin 2016 shpenzimet jetike familjare janë në shumën totale 542,000 lekë (261,655 + 280,345 = 542,000 lekë). Pra, 26.139 lekë më pak se sa janë llogaritur nga Komisioni

në analizën e saj financiare (568,139 - 542,000 = 26.139 lekë). Shumë kjo e cila duhet që të zbritet nga balanca negative që Komisioni ka konstatuar për vitin 2016 në vlerën 141,133 lekë.

Së dyti, sipas përllogaritjeve të INSTAT në 'Anketën e Buxhetit të Familjes', përfshihet ndër të tjera dhe strehimi, ku futet qiraja e paguar, mobilje për pajisje për shtëpinë, si dhe shpenzime për pije alkoolike, duhan e transport që përfshijnë rreth 15% të shumës së përgjithshme të konsumit vjetor, në rastin konkret rreth **81,300 lekë**. Ndërkohë që familja ime nuk ka pasur shpenzime për mobilim, qira dhe pije alkoolike, ndërsa shpenzimet e transportit mua më janë llogaritur njëherë nga KPK-ja në zë më vete. Gjithashtu, duke llogaritur faktin që në këtë vit unë kam qenë në regjim të rreptë kursimi dhe përllogaritja e shpenzimeve bëhet mbi mesataren, pasi është e pamundur që të përllogariten me saktësi.”

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Në lidhje me shpjegimin e parë të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka bërë referim të gabuar të shpenzimeve jetike për frymë për vitin 2016, pasi, sipas statistikave të INSTAT-it që ILDKPKI-ja i është referuar në shkresën me nr. *** prot., datë 4.3.2019, shpenzimi jetik për frymë i marrë në llogaritje nga subjekti është shpenzimi jetik për vitin 2015 dhe jo për vitin 2016.

Në lidhje me shpjegimin e dytë të subjektit, Komisioni vlerëson se shpenzimet jetike të llogaritura në analizën financiare janë shpenzime jetike të përcaktuara nga një praktikë tashmë e standardizuar dhe e konsoliduar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, e aplikuar për të gjithë subjektet e rivlerësimit. Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti nuk ka pretenduar uljen e këtyre zërave të shpenzimeve edhe në vitet e tjera ku ka rezultuar me balancë pozitive, duke mos e justifikuar në këtë mënyrë sjelljen konsumatore të pretenduar prej tij.

Pavarësisht sa më sipër, mungesa e burimeve të ligjshme për vitin 2016 dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit, në shumën – 141,133 lekë, është në një vlerë të papërfillshme në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe marrë për bazë dhe parimin e proporcionalitetit, ajo nuk mund të sjellë si pasojë plotësimin e elementëve për t'u konsideruar si një deklaram i pamjaftueshëm, që do të çonte në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

6. Hua e marrë nga shtetasi E.B., në datën 10.4.2015, në shumën 420,000 lekë, pa interes dhe pa afat, për blerjen e apartamentit.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2015 subjekti ka deklaruar: “*Hua e marrë nga shtetasi E.B., në datën 14.4.2015 në shumën 420,000 lekë pa afat*”.

Subjekti ka depozituar:

- deklaratën noteriale, datë 28.10.2016¹⁹, me deklarues E.B., i cili deklaron se: “... deklaroj se i kam dhënë hua shumën prej 420,000 lekësh në datën 14.4.2015, sipas mandatit bankar në ‘Raiffeisen Bank’. Kjo shumë i është dhënë hua shtetasit Erjon Çela për blerje apartamenti”. Erjon Çela deklaron se: “...deklaroj se e kam marrë hua shumën e lartpërmendur nga E.B., për blerje apartamenti”;

¹⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2016.

- *nxjerrje llogarie nga "Raiffeisen Bank" në datën 28.10.2016, ku E.B., ka transferuar në llogari të Erjon Çelës më 14.4.2015, shumën 420,000 lekë, me përshkrimin "dhënie huaje për apartament".*

Gjatë hetimit subjekti ka deklaruar se huaja është marrë pa afat dhe pa interes dhe se e ka shlyer plotësisht në datën 19.12.2019. Pagesën e kësaj huaje subjekti e provon me dokumentin bankar të "Credins Bank" ku pasqyron derdhje në shumën 420,000 lekë në datën 19.12.2019 në favor të shtetasit E.B., me përshkrim "*pagoi deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2016*".

Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të shtetasit E.B., subjekti ka deklaruar se shumata e dhënë hua është marrë nga të ardhurat e tij të fituara nga puna si noter publik.

Për të provuar këto të ardhura, subjekti ka depozituar: (i) ekstrakt të lëshuar nga QKB-ja ku vërtetohet se shtetasi E.B., ushtron aktivitetin e personit fizik të zyrës noteriale me NIPT *** që nga data 27.10.2016; (ii) ekstrakt të lëshuar nga QKB-ja ku vërtetohet se shtetasi E.B., ka ushtruar aktivitetin e personit fizik të zyrës noteriale me NIPT *** që nga data 2.5.2013; si dhe (iii) deklaratën analitike për tatimin mbi të ardhurat e personit fizik "E.B." për periudhën tatimore të vitit 2013.

Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë²⁰ konfirmon se subjekti "E.B." me NIPT ***, figuron i regjistruar në datën 2.5.2013 dhe i çregjistruar prej datës 14.12.2016 dhe ka depozituar: (i) formularët e deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 – 2016; (ii) formularët e situatës financiare të TVSH-së për periudhën 2013 – 2016; (iii) formularët e pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën maj 2013 – tetor 2016; (iv) pasqyrat financiare për periudhën 2014 – 2015 të depozituara online; (v) formularët e pagesave të tatimit mbi qiranë për periudhën janar 2015 – tetor 2016.

Sipas pasqyrave financiare për periudhën 2013 – 2014 konfirmohet se të ardhurat *neto* të përfituara në vitin 2013 janë në shumën 702,478 lekë dhe në vitin 2014 janë në shumën 845,230 lekë. Nga pasqyrat financiare konfirmohet pagesa e detyrimit për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.

Shpenzimet jetike për vitin 2013 – 31.03.2015 janë në shumën 417,091 lekë.

"Alpha Bank"²¹ konfirmon se shtetasi E.B. në datën 20.3.2013 rezulton bashkëkredimarrës (me nënën e tij) në një kontratë kredie bankare për shtëpi në shumën 4,000,000 lekë. Shpenzimet e kryera për pagesat e kësteve të kredisë për periudhën mars 2013 – mars 2015 rezultojnë të jenë në shumën 1,197,452 lekë.

Gjatë hetimit, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime se përse huaja nuk është përdorur për blerjen e apartamentit.

Subjekti në përgjigjen e tij ka deklaruar se huaja e marrë nga shtetasi E.B. është marrë dhe është përdorur me qëllim për blerjen e apartamentit duke mbuluar pagesën e komisionit bankar të kredisë, prej 862 euro, pagesat për shpenzimet noteriale (për kontratën e kredisë, kontratën e hipotekës dhe kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme), shpenzimet në ZVRPP, si dhe pagesa e disa kësteve të kredisë me pjesën e mbetur.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 24.7.2020, nga DRT-ja Korçë.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.5.2020, nga "Alpha Bank".

Lidhja me shtetasin E.B.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Me këtë shtetas kemi njohje të hershme që nga koha kur kemi qenë nxënës në shkollë të mesme. Gjithashtu, kemi kryer edhe universitetin pranë Fakultetit të Drejtësisë për vitet 2004 – 2008.”*

Komisioni ka hetuar edhe çështjen e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin E.B. dhe për këtë arsye ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Tropojë. Këto dy gjykata²² kanë konfirmuar se nuk rezulton të jenë dhënë vendime gjyqësore ndaj këtyre shtetasve.

Pas kalimit nga Komisioni të barrës së provës me dërgimin e rezultateve të hetimit, se:

- **duket si një veprim jashtë logjikës ekonomike dhënia hua nga shtetasi E.B. subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që huadhënësi kishte vetë kredi bankare dhe paguante këstet e saj;**
- **duket se personi tjetër i lidhur me subjektin, z. E.B., nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e shumës 420,000 lekë me burime të ligjshme dhënë hua subjektit të rivlerësimit në vitin 2015, pasi shtetasi E.B. ka marrë një kredi prej 4,000,000 lekësh bashkë me nënën e tij në vitin 2013 për blerje apartamenti.**

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet, si vijon:

*“Së pari, lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit E.B. konstatoj se....sipas kontratës së kredisë rezulton se kredimarrës i vetëm nuk është z. E.B., por edhe nëna e tij znj. F.B., ndërsa në cilësinë e dorëzanësit është babai i tij, z.B.B.. Ndodhur në këto kushte, për të parë mundësinë e likuidimit të kësaj kredie bankare nuk mund të merren vetëm të ardhurat si noter të z. E.B., por të ardhurat familjare, në kushtet kur si debitor ndaj bankës kanë dalë familjarisht. Prandaj, nga Komisioni çmohet se duhet të merren në konsideratë të ardhurat familjare. Nëna e huadhënësit, z. E.B., ka qenë e punësuar në periudhën 1971 - 2013 (dalë në pension), pa shpëputje si infermiere-mami.. Kjo provohet me librezën e punës dhe dosjen pensionit të znj. F.B. Gjithashtu, babai i subjektit, shtetasi B.B. sipas ekstraktit të QKB-së i datës 21.9.2020, rezulton i regjistruar si person fizik në datën 28.8.2008 me NIPT *** me objekt të veprimtarisë “Tregtim me pakicë të artikujve ushqimor”. Nga këto prova provohet se burimet familjare për të përballuar pagimin e kësteve të kësaj kredie janë: (i) të ardhurat nga noter të z. E.B.; (ii) të ardhurat nga puna dhe pensioni mbi 40 vjet të znj. F.B.; si dhe (iii) të ardhurat nga biznesi i vogël i z. B.B. Nisur nga këto fakte duhet prezumuar se z. E.B., ka paguar vetëm gjysmën e kësteve të kredisë në shumën 1,197,452 lekë për periudhën mars 2013 – mars 2015. Pra, gjysma e kësaj shume është në vlerën 598,726 lekë. Për rrjedhojë, duke mbajtur parasysh të ardhurat totale që ka pasur nga puna si noter për vitet 2013 – 2014 të cilat janë në shumën 1,547,708 lekë dhe duke i zbritur kësaj shume shpenzimet e minimumit jetik për vitin 2013 deri më 31.3.2015 të cilat janë në shumën 417,091 lekë, si dhe shumën 598,726 lekë që prezumohet që ka shlyer këste kredie, arrihet në përfundimin se z. E.B., ka pasur mundësi për të kursyer shumën prej 531,891 lekësh, vlerë që e mbulon plotësisht huan e marrë nga ana ime në shumën 420,000 lekë.*

²² Shkresë nr. ***prot., datë 22.5.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë; shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

*Gjithashtu, nga ana e z.E.B., më është vendosur në dispozicion Kontrata e qirasë me nr. *** rep., dhe *** kol., datë 21.2.2013, me palë: qiradhënës E.B., dhe qiramarrës: A.A., me objekt: dhënie me qira të një dyqani me sipërfaqe 27,6 m², të ndodhur në ***, Tiranë. Sipas kësaj kontrate rezulton se dyqani i është dhënë me qira qiramarrësit prej një afati prej dy vjetësh 1.1.2013 – 31.12.2014. Vlera e qirasë mujore është në shumën 60,000 lekë. Pra, vetëm për këtë periudhë dyvjeçare z. E.B., ka realizuar të ardhura nga qiraja në shumën totale 1, 440,000 lekë. Kësaj shume i hiqen tatimi mbi fitimin 15% i cili sipas nenit 33 pika 1 germa “dh” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili mbahet në burim nga qiramarrësi duke qenë se ka marrë me qira një njësi tregëtare për të ushtruar aktivitet tregtar...*

Së dyti, shuma prej 420,000 lekësh që kam marrë hua nga z. E.B., nuk më ka shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie që kam deklaruar në deklaratën “Vetting”. Kjo shumë është përdorur për shpenzime operative që lidhen me pagesat për disbursimin e kredisë, për vendosjen e pasurisë së paluajtshme në hipotekë në favor të bankës..., për pagesën e shpenzimeve noteriale për hartimin e kontratës së kredisë, hipotekës dhe shitjes së pasurisë së paluajtshme, si dhe shpenzime të tjera të nevojshme të shpjeguara më hollësisht në përgjigjet e pyetësorit përkatës. Ndodhur në këto kushte, kjo shumë në kuadër të deklaratës vjetore ashtu dhe deklaratës “Vetting” nuk hyn në zërin e asetëve por si detyrim ndaj personave të tretë, pasi është konsumuar brenda vitit kalendarik 2015...Pra, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se në kohën që kam plotësuar deklaratën “Vetting” kam pasur një detyrim ndaj shtetasit E.B., dhe e kam deklaruar atë me saktësi. Theksohet se shuma e marrë hua në vlerën 420,000 lekë është konsumuar që në vitin 2015 dhe nuk ka ekzistuar në ditën e plotësimit të deklaratës “Vetting.”

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqës

Trupi gjyqës vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota, si dhe ka paraqitur dokumentacion të plotë provues në lidhje me mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. E.B., për dhënie e huas në shumën 420,000 lekë, të krijuar me burime të ligjshme financiare, duke e përfshirë këtë shumë në rezultatin përfundimtar të analizës financiare të subjektit të rivlerësimit.

7. Kredi në “Raiffeisen Bank” në shumën 765,000 lekë me interes 13.26 % me afat 7-vjeçar, me këst mujor 14,025 lekë. Fillon në datën 8.5.2015 dhe përfundon në datën 8.6.2022.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë së vitit 2015 subjekti ka deklaruar: “Kredi në ‘Raiffeisen Bank’ në shumën 765,000 lekë me afat 7-vjeçar... fillon me datë 12.07.2013 dhe përfundon me datë 12.07.2020”.

Subjekti ka depozituar kontratën e kredisë bankare, datë 4.6.2015, me kredidhënës “Raiffeisen Bank” dhe kredimarrës Erjon Çela për dhënie e kredisë më shumën 765,000 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë është për qëllime personale.

Kredia është disbursuar në datën 8.6.2015 dhe në po të njëjtën datë shuma prej 430,982.14 lekësh ka shkuar për mbylljen e kredisë të marrë në vitin 2013 nga subjekti i rivlerësimit në shumën 520,000 lekë të padeklaruar prej tij në deklaratën periodike të vitit 2013, ndërsa pjesa tjetër është tërhequr *cash* nga subjekti.

Nga hetimi rezultoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me kredinë në “Raiffeisen Bank” në shumën 765,000 lekë, përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga banka.

8. Overdraft në “Raiffesien Bank” në shumën 140,000 lekë. Aktualisht pa shlyer shuma prej 134,758.07 lekësh.

Subjekti në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2015 ka deklaruar: “*Overdraft në ‘Raiffeisen Bank’ në shumën 140,000 lekë*”.

Subjekti ka depozituar dokumentin bankar të lëshuar nga “Raiffeisen Bank” që konfirmon kontratën e kredisë *overdraft* akorduar Erjon Çelës në shumën 140,000 lekë në datën 21.9.2015.

“Raiffeisen Bank” konfirmon llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit me gjendje në shumën -134,266.77 lekë në datën 30.1.2017.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se deklarimi i subjektit, në lidhje me kredinë overdraft të marrë në “Raiffeisen Bank” në shumën 140,000 lekë, përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga banka.

9. Kartë krediti në “Raiffeisen Bank” në shumën 700 euro. Në gjendje pa shlyer shuma prej 413.81 euro.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2014 subjekti ka deklaruar: “*Kartë krediti në ‘Raiffeisen Bank’ në shumën 700 euro*”, që vërtetohet me marrëveshjen mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit - *mastercard* të lidhur midis “Raiffeisen Bank” dhe subjektit të rivlerësimit në datën 9.11.2012 në shumën 700 euro.

“Raiffeisen Bank”²³ konfirmon llogari tërheqje me *Master Card* në monedhën euro në emër të subjektit të rivlerësimit të aktivizuar në datën 31.1.2013 nga ku janë kryer tërheqje *cash* nga subjekti pagesat për detyrimet e kartës. Llogaria rezulton me gjendje -418.81 euro në datën 30.1.2017.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se deklarimi i subjektit, në lidhje me kartën e kreditit në “Raiffeisen Bank” në shumën 700 euro, përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga banka.

KONSTATIME TË TJERA

10. Në lidhje me mjetet në përdorim

Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se për një periudhë prej 60 muajsh (nga dhjetori i vitit 2017), ka përdorur autoveturën tip “Mercedes Benz” me targa *** në pronësi të shtetasit M.Sh., në bazë të një prokure të posaçme, i kthyer pronarit kur subjekti ka blerë automjetin që ka aktualisht në pronësi.

Subjekti ka shpjeguar se me shtetasin M.Sh., kanë shoqëri shumë të hershme, e cila vazhdon edhe aktualisht.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

Komisioni ka hetuar mbi çështjen e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin M.Sh., dhe nga korrespondenca e kryer me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Tropojë²⁴, nuk ka rezultuar ndonjë situatë e tillë.

Nga hetimi nuk u konstatuan problematika në lidhje me përdorimin e mjetit në pronësi të shtetasit M. Sh., nga subjekti i rivlerësimit.

11. Kredi në “Raiffeisen Bank” në shumën 520,000 lekë, me interes 13.61 %, me afat 7 vjet. Fillon më 12.7.2013 dhe përfundon më 12.7.2020

“Raiffeisen Bank”²⁵ ka konfirmuar kredinë bankare të marrë nga subjekti sipas kontratës së datës 12.7.2013, në shumën 520,000 lekë për qëllime personale.

Kredia është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të pasurisë së viteve 2014 dhe 2015, por nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2013.

Pas kërkesës së Komisionit me rezultatet e hetimit, për të dhënë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e kësaj kredie në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se mosdeklarimi i kredisë në deklaratën e pasurisë së vitit 2013 është një harresë dhe është korrigjuar me deklarimin e bërë në deklaratën e pasurisë së vitit 2014, duke e konsideruar një qasje të pakujdesshme të tij në drejtim të plotësimit me përpikërinë e duhur të deklaratës periodike të pasurisë. Subjekti sqaron se gjendja e kredive bankare është lehtësisht e verifikueshme dhe e kontrollueshme, për sa kohë që janë llogari brenda sistemit bankar.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se kredia prej 520,000 lekësh nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurisë së vitit 2013, por subjekti e ka deklaruar atë më pas në deklaratat e pasurisë së viteve 2014 dhe 2015.

Fakti i deklarimit të kësaj kredie në deklaratat e pasurisë në vitet 2014 dhe 2015, shuan çdo dyshim të trupit gjykues për ndonjë qasje apo veprim nga subjekti me qëllim fshehjen e kësaj kredie, për më tepër që edhe dokumentet bankare e konfirmojnë këtë marrëdhënie kredie.

Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit në shumën 520,000 lekë, në vitin 2013, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, është një pasaktësi që nuk plotëson elementet e nevojshme për t’u konsideruar si shkak që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016 dhe, si i tillë, nuk duhet të përdoret si shkak/konkluzion mbi të cilin mund të mbështet një vendimmarrje për shkarkimin e subjektit nga detyra.

12. Kartë krediti në “Raiffeisen Bank” në shumën 50,000 lekë

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë së vitit 2014 subjekti ka deklaruar: “*Kartë krediti në ‘Raiffeisen Bank’ në shumën 50,000 lekë*”.

Subjekti ka depozituar marrëveshjen mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit, *Mastercard*, të lidhur me “Raiffeisen Bank” në datën 22.5.2012, në shumën 50,000 lekë.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë; shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

²⁵ Shkresa me nr. *** prot., datë 10.2.2020, e “Raiffeisen Bank”.

“Raiffeisen Bank”²⁶ konfirmon llogari tërheqjeje me *Mastercard* në emër të subjektit të rivlerësimit të aktivizuar në datën 31.7.2012, nga ku janë kryer tërheqje *cash* dhe janë kryer pagesat për detyrimet e kartës. Llogaria rezulton me gjendje 0 lekë në datën 31.12.2016.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet në lidhje me kartën e kreditit në “Raiffeisen Bank” në shumën 50,000 lekë me dokumentacionin e përcjellë nga banka.

13. Analiza financiare

- a. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Çela, për të gjithë periudhën e rivlerësimit 2011 – 2016.
- b. Pas shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni vlerësoi të përfshijë në analizën financiare të subjektit huan e dhënë nga personi tjetër i lidhur, shtetasi E.B., në shumën 420,000 lekë, si shumë e krijuar me burime të ligjshme financiare.
- c. Përfundimisht, nga kjo analizë për periudhën e rivlerësimit 2011 – 2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, për të blerë pasuritë, për të krijuar likuiditetet dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e jetesës të evidentuara gjatë periudhës së rivlerësimit 2011 – 2016, vetëm në vitin 2016, në shumën -141,133 lekë, të cilën Komisioni në bazë të parimit të proporcionalitetit e vlerëson si të papërfillshme duke mos prodhuar pasoja të tilla, që mund të çojnë në konkluzionin se ndodhemi përpara një deklarimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra referuar 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

²⁶ Shkresa me nr. *** prot., datë 10.2.2020, e “Raiffeisen Bank”.

Përshkrimi	01.11.2011- 31.12.2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	160,610	1,119,270	1,068,008	1,525,114	1,241,449	1,606,127
Të ardhura nga paga në gjykatë	119,210	870,870	807,608	1,138,006	1,130,830	1,113,005
Të ardhura nga paga e babait	41,400	248,400	260,400	387,108	110,619	-
Të ardhura nga paga e nënës	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga paga e vëllait	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga paga e bashkëshortes						357,502
Të ardhura nga leja e lindjes						135,620
Detyrime	-	120,000	663,000	300,000	9,616,868	-
Kredi 520,000 në RBAL_2013			520,000			
Kredi 143,000 në RBAL_27.06.2013			143,000			
Kredi në Union Bank_48,000 Euro_08.06.2015					6,764,640	
Hua e marrë FK_10.04.2015					1,667,228	
Hua e marrë nga E.B 420,000_14.04.2015					420,000	
Kredi 765,000 në RBAL_04.06.2015					765,000	
Kredi Fondi Besa 120,000_17.04.2012_AC		120,000				
Kredi Alpha Bank_300,000 ALL_01.12.2014_AC				300,000		
Shpenzime	91,080	792,176	1,537,129	1,422,242	2,195,445	1,293,206
Shpenzime jetike	91,080	564,096	564,096	879,992	392,483	568,139
Shpenzime mobilimi	-	-	-	-	270,000	-
Shpenzime udhëtimi	-	60,080	-	3,503	688	
Shpenzime intersi kartë krediti	-	-	26,157	25,489	26,800	19,078
Shpenzime kredie RBAL			211,876	132,258	598,176	164,595
Shpenzime kredie Union					338,634	486,394
Shpenzime kredie Alpha				6,000	20,547	
Shpenzime kredie Fondi Besa		48,000	72,000			
Shpenzime udhëtimi Tropojë (pune)	-	-	-	75,000	120,000	55,000
Kredi e shpenzuar	-	120,000	663,000	300,000	330,000	-
Shpenzime për mjetin	-	-	-	-	12,291	
Hua e shpenzuar	-	-	-	-	85,826	-
Pasuri	9,740	43,937	(218,334)	(92,135)	8,584,003	454,054
Ndryshim likuiditete (shtesa/pakësime)	9,740	43,937	(218,334)	(92,135)	85,444	454,054
Shtëpi private 200 m2 Lagjia nr.1. *****						
Apartament me sip 90.21 m2 *****	-	-	-	-	8,428,698	-
Autoveturë tip Peugeot 206HDI me targë *****	-	-	-	-	69,860	-
Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri	59,790	403,158	412,213	495,007	78,870	-141,133

Metodologjia e kryerjes së analizës financiare

Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Njësia e Shërbimit Ligjor përgatiti analizën financiare të mbështetur në të dhënat e deklarimeve periodike vjetore në ILDKPKI, në deklaratën “Vetting”, në informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse dhe deklaratimet e subjektit. Z. Erjon Çela ka qenë subjekt deklarimi pa ndërprerje që prej vitit 2011.

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e familjes së tij.

- Të ardhurat nga pagat e dokumentuara për subjektin²⁷, bashkëshorten²⁸ dhe personat e lidhur me të²⁹; të ardhura nga shitja e pasurive sipas kontratave përkatëse.

- Detyrimet bankare janë pasqyruar sipas kontratave të kredive bankare, ndërsa huat për të cilat është provuar burimi i ligjshëm i tyre sipas deklaratës noteriale³⁰ dhe kontratës së huas³¹.

- Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur duke u bazuar në standardin e ILDKPKI-së dhe sipas përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit. Përbërja familjare, për efekt të përlllogaritjes së shpenzimeve, është ndarë në këto periudha: 1.11.2011 – 31.3.2015 ku shpenzimet jetike janë llogaritur për familje me 4 anëtarë, pasi subjekti ka deklaruar në pyetësonin standard se ka jetuar me familjen e tij, e cila përbëhet nga babai, nëna dhe vëllai, ndërsa për periudhën 1.4.2015 – 31.12.2015 janë llogaritur për 1 anëtar, pasi subjekti ka deklaruar se është shkëputur nga trangu familjar³²; për periudhën 1.1.2016 - 31.7.2016 shpenzimet jetike janë llogaritur për 2 anëtarë³³, ndërsa nga muaji gusht deri më 31 dhjetor me 3 anëtarë. Janë përfshirë shpenzimet për mobilim sipas deklaramit të subjektit në pyetësonin nr. 2; shpenzimet për pagesat e kësteve të kredive sipas nxjerrjes së llogarive bankare; shpenzimi i kredisë sipas tërheqjes së kryer në bankë me qëllim përdorimi personal; shpenzimi i huas sipas vlerës së mbetur të huas pas shlyerjes së kesteve të kredisë; shpenzimet e udhëtimit bazohen në raportin nga sistemi *TIMS* dhe sqarimet e dhëna nga subjekti në pyetësonin standard, ndërsa shpenzimet e udhëtimit për qëllime pune i referohen shpenzimeve të mbulura nga subjekti dhe të deklaruara prej tij në pyetësonin nr. 2.

- Pasuritë, ku përfshihen të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi dhe bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortes. Çdo pasuri është regjistruar në atë datë/vit kur është paguar. Secila nga pasuritë është analizuar në kohën e krijimit të saj. Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e shitblerjeve, deklaratat noteriale, mandatpagesat, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, e ballafaquar me deklaratën “Vetting” dhe DPV-të. Shuma në fund përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në krijimin e pasurisë së fundit.

- Likuiditetet trajtohen si pjesë e pasurive në një zë të veçantë: gjendjet *cash* dhe llogaritë bankare³⁴ në fund të çdo viti/datë të analizuar për çdo person të familjes.

²⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2020, nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim nr. *** prot., datë 27.1.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec për periudhën 2011 – 2013; vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë për periudhën 2014 – 2016;

²⁸ Vërtetim nr. *** prot., datë 16.1.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 14.4.2015 - 31.12.2016; vërtetim nr. *** prot., datë 22.6.2020, nga ISSh-ja Tiranë për të ardhurat nga leja e lindjes.

²⁹ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga Bashkia Pogradec për periudhën 1.11.2011 – 31.3.2014; vërtetim datë 15.1.2020 nga Zyra Vendore Arsimore Pogradec për periudhën 1.4.2014 - 31.12.2014; vërtetim datë 16.1.2020, nga shkolla teknike profesionale “E.Q.” për periudhën 1.1.2015 - 31.3.2015.

³⁰ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2016.

³¹ Kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.4.2015.

³² Certifikatë familjare nr. *** , ku rezulton se në përbërjen familjare datë 31.3.2015 është vetëm z. Erjon Çela.

³³ Në datën 5.1.2016 subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me shtetasen K.Sh., sipas certifikatës familjare nr. ***.

³⁴ Shihni: shkresa nr. *** prot., datë 10.2.2020, nga “Raiffeisen Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2020, nga “Credins Bank”; shkresa nr. prot. *** , datë 19.2.2020, nga “ProCredit Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 17.2.2020, nga “Tirana Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 20.2.2020, nga “OTP Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 21.2.2020, nga BKT-ja; shkresa nr. *** prot., datë 21.2.2020, nga “Union Bank”; shkresa nr. *** prot , datë 10.2.2020, nga “Alpha Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 5.2.2020, nga “ABI Bank”.

Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për një vit të caktuar ushtrimor.

Rezultati është përlllogaritur për çdo vit kalendarik, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total dhe rezulton si shumatore e: të ardhurave + detyrime – shpenzime – pasuri.

Mundësia financiare është analizuar për çdo pasuri të krijuar në momentin e pagesës për pasurinë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision me shkresën nr.*** prot., datë 4.8.2020 raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017 për subjektin e rivlerësimit, z. Erion Çela, i deklasifikuar plotësisht.

Nga grupi i punës është konkluduar se: *“Për subjektin e rivlerësimit, z. Erion Çela, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”.*

Pavarësisht këtij konstatimi, Komisioni kërkoi përsëri përditësim të dhënash për subjektin e rivlerësimit dhe informacione në lidhje me një kontakt të tij, për të cilin DSIK-ja³⁵ konfirmoi se nuk rezultuan të dhëna.

Gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi asnjë e dhënë për veprimtari korruptive apo kontakte me persona të papërshtatshëm në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Çela.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizë të të gjitha fakteve dhe provave të administruara nga Komisioni, nuk u konstatuan elemente që çënojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, parashikuar nga neni Dh i Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Grupi i punës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar dhe përcjellë në Komision raportin nr.*** prot., datë 7.8.2018, për të analizuar aftësitë profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Çela.

Në raport janë analizuar dhe është konkluduar në bazë të të dhënave që kanë rezultuar nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

³⁵ Tri shkresa “sekret” të DSIK-së.

✓ **Aftësitë profesionale**

a) *Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit nuk ka ende njohuri të plota në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 2 çështje, subjekti ka gabuar në identifikimin e normës ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, që lidhej me vërtetimin gjyqësor të fakteve juridike për shkak të mungesës së dokumenteve, duke i shqyrtuar ato si padi me palë kundërshtare.

Lidhur me jurisprudencën e gjykatave më të larta nuk mund të nxirret përfundim mbi nivelin e njohurive të tij, pasi përdorimi i tyre prej gjyqtarit Erjon Çela është i kufizuar vetëm për institutin e gjykimit të shkurtuar, ku ai i përdor referencat në mënyrë të standardizuar – vendimin nr. *** të Gjykatës Lartë dhe vendimet nr. 4/2012 dhe nr. 24/2012 të Gjykatës Kushtetuese.

Në tri dokumentet ligjore nuk kuptohet nëse është ushtruar ankim ndaj vendimeve të tyre, pasi ato nuk janë paraqitur në format zyrtar të njësuar dhe nuk mbajnë shënime mbi këtë tregues. Ndërsa në pesë dosjet e vëzhguara nuk është ankimuar asnjë vendim nga palët. Rrjedhimisht, vendimet kanë marrë formë të prerë të paverifikuara nga gjykatat më të larta.

b) *Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mira për sa i përket arsyetimit ligjor.

Subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela, ka treguar aftësi të mira në drejtim të:

✓ **Aftësi organizative**

a) *aftësia për të përballuar ngarkesën në punë;*

b) *aftësia për të kryer procedurat gjyqësore;*

c) *aftësia për të administruar dosjet.*

✓ **Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale**

a) *etika në punë;*

b) *integriteti;*

c) *paanësia.*

✓ **Aftësi personale dhe angazhimit profesional**

a) *aftësia e komunikimit;*

b) *aftësia për të bashkëpunuar;*

c) *gatishmëria për t'u angazhuar.*

Subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela, përkatësisht me vendimet nr. ***, datë 11.10.2013 dhe nr. ***, datë 4.11.2016, të KLD-së, është vlerësuar “shumë mirë”, për periudhat kohore 2005 – 2006 dhe 2007 – 2009.

Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë sipas shtojcës së ligjit dhe nuk ka mangësi apo kundërthënie në përmbajtje. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të dhënat statistikore, duke referuar si periudhë të rivlerësimit vitet “2013, 2014, 2015 dhe 4.11.2016”.

Tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Vlerësimi nga grupi vlerësues pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë i tri dokumenteve të paraqitura nga subjekti

Subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor. Një prej këtyre vendimeve i përket vitit 2014, një vendim i përket vitit 2015 dhe një vendim vitit 2016.

Në analizë të përbashkët të tri dokumenteve konstatohet se subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve. Organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të mesatar.

Këto tri vendime përshkruhen si vijon:

Dokumenti 1 – vendimi nr. ***, datë 8.7.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë që i përket paditësit E.M., kundër të paditurit “***” sh.a., me objekt “shpërblimi i dëmit nga zgjidhja e pajustificuar e marrëdhënieve të punës”.

Dokumenti 2 – vendimi nr. ***, datë 1.12.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë që i përket Prokurorisë së Rrethit Tropojë me objekt “vleftësim i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktim i masës së sigurimit ‘arrest në shtëpi’ ndaj të dyshuarit D.Gj., për veprën penale të kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik” të parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal”.

Dokumenti 3 – vendimi nr. regj. them. ***, datë 20.1.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë që i përket Prokurorisë së Rrethit Tropojë kundër të pandehurit E.D., i akuzuar për veprën penale “kultivim i bimëve narkotike” të parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal.

Për të tri dokumentet e depozituara, subjektit, me rezultatet e hetimit, i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me konstatimet e grupit të punës pranë KLD-së, si vijon:

- nuk janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe;
- shpenzimet gjyqësore janë përmendur në vendim, por nuk janë specifikuar me vlerat përkatëse;
- vendimi i gjykatës nuk ka nënshkrimin e sekretares gjyqësore dhe të gjyqtarit dhe as nuk është kopje e njehsuar me origjinalin (mund të jetë kopje e printuar nga sistemi).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kërkesës për të dhënë shpjegime

Në lidhje me faktin se tri vendimet gjyqësore të mësipërme nuk kanë nënshkrimin e sekretares gjyqësore dhe të gjyqtarit përkatës, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision tri vendimet gjyqësore të nënshkruara rregullisht si nga gjyqtari edhe nga sekretarja gjyqësore³⁶.

³⁶ Shihni vendimin gjyqësor civil nr. ***, datë 8.7.2014; vendimin gjyqësor penal nr. ***, datë 1.12.2015; vendim gjyqësor penal nr. ***, datë 20.1.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të marra nga arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë të njehsuara me origjinalin.

Gjithashtu, në lidhje me konstatimin se në këto tri dokumente ligjore nuk kuptohet nëse është ushtruar ankim ndaj vendimeve, subjekti sqaron se sipas shënimeve të bëra nga kancelari i gjykatës në fund të vendimeve konstatohet se:

- Kundër vendimit gjyqësor civil nr. ***, datë 8.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është ushtruar ankim nga pala e paditur “****” sh.a. dhe Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj nr. ***, datë 26.6.2015 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. *** datë 8.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë”*.
- Kundër vendimit gjyqësor penal (themeli) nr. ***, datë 20.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është ushtruar ankim nga i pandehuri E.D., dhe kundërankim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj nr. ***, datë 20.4.2016 ka vendosur: *“Mospranimin e ankimit të të pandehurit E.D., ...”*.
- Kundër vendimit gjyqësor penal (masë sigurimi) nr. ***, datë 20.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë nuk rezulton që të jetë bërë ankim brenda afatit ligjor dhe, për këtë arsye, vendimi ka marrë formë të prerë (sipas shënimit të bërë nga kancelari i gjykatës).

Në lidhje me specifikimin e shpenzimeve gjyqësore që nuk janë pasqyruar në fund të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 8.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë (është përcaktuar në dispozitivin e vendimit vetëm se cilës palë i ngarkohen), subjekti sqaron se në të gjitha rastet kur gjatë gjykimit janë evidentuar shpenzime gjyqësore të kryera nga palët dhe të provuara me dokumentacion justifikues është bërë pjesë e vendimit edhe tabela përmbledhëse e shpenzimeve gjyqësore. Në rastin konkret rezulton se kjo tabelë nuk është pasqyruar kjo për shkak të një gabimi të bërë gjatë printimit të vendimit gjyqësor nga sekretarja gjyqësore.

Në lidhje me mospërdorimin e të gjitha karaktereve të gjuhës shqipe, subjekti sqaron se kjo mangësi është rregulluar në vazhdim.

Trupi gjykues, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionin justifikues ligjor të depozituar prej tij në përgjigje të rezultateve të hetimit, i vlerëson ato të mjaftueshme duke mos konstatuar problematika thelbësore që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit për kriterin profesional.

Pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv

Dosja 1 – çështja penale nr. *** regj. them., datë 14.2.2014 regjistrimi. që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me objekt “mbajtje e masës së sigurimit ‘arrest me burg me afat 40 ditë me qëllim ekstradimi”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 17.2.2014.

Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, duke mbajtur masën e sigurimit “arrest në burg” me afat 40 ditë me qëllim ekstradimi sipas vendimit nr. ***, datë 7.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë ndaj shtetasit E.D. Procesverbali është nënshkruar nga sekretari gjyqësor dhe gjyqtari.

Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela, ka zgjatur gjithsej 3 ditë dhe vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit brenda ditës, duke respektuar afatin 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi është dhënë nga gjyqtari Erion Çela brenda 10 ditëve nga caktimi i masës “arrest në burg”, duke respektuar afatin 10-ditor të përcaktuar nga neni 495/4 i Kodit të Procedurës Penale dhe standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimit, të parashikuar nga pika 2 e nenit 28 të Kushtetutës dhe pika 3 e nenit 5 të KEDNJ-së.

Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor dhe janë dokumentuar rregullisht.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk ka të meta.

Trupi gjykues, nga hetimi i dosjes gjyqësore nuk konstatoi problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit për kriterin profesional.

Dosja 2 – çështja civile nr. *** regj. them., datë 5.11.2014 regjistrimi, që i përket paditësit E.D., kundër të paditurës M. D. dhe personit të interesuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me objekt “heqjen e së drejtës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për të miturin A.D., të datëlindjes 24.8.2005 dhe ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga xhaxhai i të miturit E.D.”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.12.2014.

Gjyqtari Erjon Çela, me vendim formal të datës 7.11.2014 (pas 2 ditëve) ka caktuar seancën përgatitore më 12.11.2014, ora 12:30. Caktimi i datës së seancës është në shkelje të afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile³⁷, pa kërkesë nga palët dhe pa vendim të motivuar të gjyqtarit.

Me vendimin nr. ***, datë 23.12.2014 ka vendosur: pranimin e padisë së ngritur nga paditësi E.D.; heqjen e përgjegjësisë prindërore të të paditurës M.D., ndaj fëmijës A.D.; caktimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijën A.D., të datëlindjes 24.8.2005 xhaxhait të tij paditësit E.D.

Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim. Ai ka marrë formë të prerë në datën 7.1.2014.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit brenda afatit 10-ditor ligjor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti është brenda afatit standard 4-mujor të përcaktuar nga germa “d”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit duke respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor.

Janë kryer veprimet e duhura procedurale për organizimin e procesit gjyqësor dhe janë dokumentuar rregullisht.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk ka të meta.

Subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit, për të dhënë shpjegime në lidhje me konstatimin e Grupit të Punës në KLD se: *“është evidentuar se nga subjekti i rivlerësimit është caktuar seanca përgatitore më 12.11.2014 (pasi çështja është regjistruar në gjykatë më 5.11.2014), duke njoftuar palët përpara afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile³⁸, pa kërkesë nga palët dhe pa vendim të motivuar të gjyqtarit (pra njoftimi*

³⁷ Neni 155 i Kodit të Procedurës Civile në fuqi në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje (përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 37/2017) parashikonte se: *“Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë”.*

³⁸ Neni 155 i Kodit të Procedurës Civile në fuqi në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje (përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 37/2017) parashikonte se: *“Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë”.*

është bërë para se të plotësohen 10 ditë nga data e regjistrimit të padisë në gjykatë”, ka shpjeguar se:

“... gjatë procedurës së kryerjes së veprimeve përgatitore në zbatim të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile jam njohur dhe me përmbajtjen e padisë ku pretendohej se përgjegjësinë prindërore për nipin e tij të mitur A.D., duhet ta ushtronte paditësi pasi nëna e fëmijës së mitur e paditura M.D., rezulton e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me 25 vjet burg, e dënuar për vrasjen e bashkëshortit të saj (babait të fëmijës së mitur).

Duke mbajtur parasysh rrethanat sa më sipër, interesimet e herëpashershme që bënte pala paditëse pranë sekretarisë së gjykatës për marrjen e datës së gjyqit, si dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës në rastin konkret të parashikuar në nenin 10 të Kodit të Familjes, i cili përcakton se ‘Organet kompetente në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij Kodi, duhet të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit’, kam disponuar me vendimin ‘Për caktimin e seancës përgatitore’, duke e caktuar seancën gjyqësore- përgatitore para afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 155/1 i Kodit të Procedurës Civile, duke çmuar se është në interesin më të lartë të të miturit që të kryhet një njoftim më i shpejtë i padisë.

Seanca e datës 12.11.2014 edhe pse është caktuar para afatit 10-ditor ka qenë një seancë gjyqësore - përgatitore, e cila ka karakter joformal...”

Nga hetimi i dosjes gjyqësore, duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues nuk konstatoi problematika thelbësore që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit për kriterin profesional.

Dosja 3 – çështja civile nr. *** regj. them., datë 10.7.2015 regjistrimi, që i përket paditësit T. Ç. kundër të paditurit ***, me objekt “njohje e vërtetësisë së faktit juridik të marrëdhënies së punës për periudhën 14.4.1973 – 30.12.1993 si punëtor nëntoke”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 16.9.2015.

Caktimi i datës së seancës është në shkelje të afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile³⁹.

Me vendimin nr. ***, datë 16.9.2015, gjykata ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë”.

Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim. Ai ka marrë formë të prerë më 1.10.2015.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit, brenda afatit 10-ditor ligjor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është kryer brenda afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e” e pikës 5 të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit. Rrjedhimisht, duke u respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor.

Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor dhe janë dokumentuar rregullisht.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk ka të meta.

³⁹ Neni 155 i Kodit të Procedurës Civile në fuqi në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje (përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 37/2017) parashikonte se: “Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë”.

Subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit, për të dhënë shpjegime në lidhje me konstatimin e grupit të punës pranë KLD-së se: *“Subjekti i rivlerësimit me vendim formal të datës 23.7.2015 ka caktuar seancën përgatitore më 28.7.2015 (pasi çështja është regjistruar në gjykatë më 10.7.2015), duke urdhëruar njoftimin e palëve, në shkëlqje të afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile⁴⁰, pa kërkesë nga palët dhe pa vendim të motivuar të gjyqtarit.*

Gjykata ka gjykuar në mënyrë të gabuar këtë çështje referuar pozitës juridike të palëve në proces, si dhe bazës ligjore të përdorur. Sipas objektit të padisë dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Civile gjykata duhej të orientonte palët për ndryshimin e pozitës juridike në proces, pra jo me ‘paditës’ por me ‘kërkues’ dhe jo të paditur por ‘person i tretë’. Gjithashtu dhe referuar kërkit të objektit që është ‘njoheje e vërtetësisë së faktit juridik...’ subjekti i rivlerësimit duhej t’i orientonte palët drejt bazës ligjore të saktë referuar nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile ‘vërtetimi gjyqësor i fakteve’, ka dhënë shpjegimet si vijojnë:

“... me vendimin e datës 23.7.2015, ‘Për caktimin e seancës gjyqësore’ është vendosur që seanca gjyqësore - përgatitore të zhvillohej në datën 28.7.2015, ora 15:00.

Edhe në këtë rast, duke mbajtur parasysh se në njoftimin e palëve nuk janë hasur vështirësi është proceduar me kryerjen e njoftimit para afatit 10-ditor.

Seanca e datës 28.7.2015 edhe pse është caktuar para afatit 10-ditor ka qenë një seancë gjyqësore përgatitore. Njoftimet kanë qenë të sakta pasi palët kanë qenë prezente gjatë gjykimit rregullisht dhe nuk kanë paraqitur asnjë pretendim në lidhje me këtë fakt...

Në lidhje me konstatimin e dytë të bërë nga grupi i punës së KLD-së, theksoj se ky konstatim nuk është i bazuar në dokumentet ligjore, pjesë e dosjes gjyqësore mbi bazën e të cilës është kryer dhe vlerësimi profesional.

Grupi i punës, për të arritur në këtë konkluzion nuk i është referuar provave shkresore që janë shqyrtuar dhe administruar gjatë gjykimit, por është bazuar vetëm në formulimin e objektit të kërkesëpadisë nga paditësi i cili ka kërkuar: ‘Njohejen e vërtetësisë së faktit juridik atë të qenies në marrëdhënie pune ...’. Ndërsa si bazë ligjore të kërkesëpadisë paditësi ka vendosur nenin 32/c të Kodit të Procedurës Civile i cili përcakton: ‘Padia mund të ngrihet: ... (c) për njohejen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin’.

Gjatë gjykimit me anën e shpjegimeve të dhëna nga palët ndërgjyqëse dhe pas shqyrtimit të provave të paraqitura nga paditësi rezultoi se dokumentacioni i vjetërsisë në punë në rastin konkret ekzistonte. U paraqit si provë në gjykim vërtetimi përkatës...

Duke mbajtur parasysh nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, vendimin unifikues nr. 9, datë 9.3.2006, të KBGJL⁴¹, si dhe vendimin nr. 8/2004 të Gjykatës Kushtetuese, gjykata si dëgjoi

⁴⁰ Neni 155 i Kodit të Procedurës Civile në fuqi në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje (përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 37/2017) parashikonte se: *“Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë”.*

⁴¹ Shihni vendimin unifikues nr. 9, datë 9.3.2006, të KBGJL-së, ku ndër të tjera përcaktohet: *“... në kuptim të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, cilësimi i saktë i fakteve dhe veprimeve (më saktë i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike) që lidhen me mosmarrëveshjen bëhet nga gjykata që shqyrton çështjen, ndërsa përcaktimi i bazës juridike të padisë bëhet nga vetë paditësi që me paraqitjen e padisë dhe është në disponimin e plotë të tij ta ndryshojë atë deri në përfundim të hetimit gjyqësor, duke i bërë kërkesë gjykatës në një formë të përshtatshme procedurale.”*

shpjegimet e paditësit të cilat në thelb referonin në bazën ligjore të vënë prej tij në kërkesëpadi (nenin 32/c të Kodit të Procedurës Civile) konstatoi se kërkimi i tij ishte njohja e pavërtetësisë së dokumentit të vjetërsisë në punë vetëm për sa i përket rubrikës detyra pasi ai pretendonte se kishte punuar si punëtor nëntoke.

*Ndodhur në këto rrethana faktike, duke mbajtur parasysh edhe faktin se gjatë gjykimit u shqyrtua si provë edhe vërtetimi nr. *** prot., datë 25.3.2015 i DRSSh-së Tropojë (me të cilin provohet se dokumentacioni i punës ekziston) theksoj se nuk kam qenë në kushtet kur paditësi duhej që të orientohej për t'iu drejtuar gjykatës me një mjet tjetër ligjor procedural siç është kërkesa e parashikuar nga neni 388 i Kodit të Procedurës Penale (vërtetimi gjyqësor i fakteve)... Në rastin konkret nuk ka ekzistuar një mungesë dokumentacioni e vjetërsisë në punë, përkundrazi gjatë gjykimit rezultoi se ai ekziston plotësisht, pasi paditësit i gjenden vitet e punës, por ka pretendime vetëm në lidhje me detyrën e përcaktuar.*

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin se gjykata e ka gjykuar në mënyrë të drejtë këtë çështje, duke identifikuar saktë normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, e cila përputhet me kërkimin e paditësit dhe me bazën ligjore të vendosur prej tij në kërkesëpadi (neni 32/c i Kodit të Procedurës Civile)."

Nga hetimi i dosjes gjyqësore, duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i vlerësoi ato të mjaftueshme, duke mos konstatuar problematika thelbësore që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit për kriterin profesional.

Dosja 4 – çështja penale nr. *** akti, datë 22.10.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë kundër të pandehurit B.Gj., i akuzuar për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake e municionit” të parashikuara nga nenet 278/5 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 1.12.2015.

Me vendimin e datës 30.10.2015, subjekti ka caktuar seancën gjyqësore më 10.11.2015, ora 11:00 në respektim të afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 333 i Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit B.Gj., për kryerjen e veprës penale “prodhimi dhe mbajtje pa leje e armëve e municionit luftarak” dhe në bazë të nenit 278/5 të Kodit Penal dhe nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e tij përfundimisht me 4 vjet e 8 muaj burgim.

Kundër vendimit nuk është ushtruar ankim.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit në sekretarinë gjyqësore jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur brenda afatit 9-mujor ditor të përcaktuar nga germa “a”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit duke u respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor në aspektin e afatit të arsyeshëm të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Janë kryer veprimet procedurale për shqyrtimin e çështjes, të cilat janë dokumentuar rregullisht.

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta.

Subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit, për të dhënë shpjegime në lidhje me konstatimin e grupit të punës pranë KLD-së se: “Vendimi dhe dosja gjyqësore janë depozituar në sekretari pas 8 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.”, ka dhënë shpjegime: “Vendimi gjyqësor është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore pas 8 ditësh nga dita e shpalljes së tij kjo pasi brenda këtij afati kanë rezultuar edhe tri ditë pushimi ...”

Nga hetimi i dosjes gjyqësore, duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues nuk konstatoi problematika thelbësore që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit për kriterin profesional.

Dosja 5 – çështja civile nr. *** regj. them., datë 21.4.2016 regjistrimi, që i përket paditësit K.M., kundër të paditurit ***, me objekt “njohjen e faktit juridik të marrëdhënies së punës për periudhën 20.2.1974 – 2.1.1979 dhe për periudhën 10.1.1981 – 30.5.1991 si punëtor bujqësie”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.5.2016.

Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit të saj.

Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit brenda afatit 10-ditor ligjor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela është brenda afatit standard 6-mujor. Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor dhe janë dokumentuar rregullisht.

Në dosje mungon akti i përfaqësimit të të paditurit, i cili nuk është fiksuar as në procesverbalin e seancave.

Subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit për të dhënë shpjegime në lidhje me konstatimin e grupit të punës pranë KLD-së se:

- “Gjykata ka gjykuar në mënyrë të gabuar këtë çështje referuar pozitës juridike të palëve në proces si dhe bazës ligjore të përdorur. Sipas objektit të padisë dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Civile gjykata duhej të orientonte palët për ndryshimin e pozitës juridike në proces, pra jo me “paditës” por me “kërkues” dhe jo të paditur por “person i tretë”. Gjithashtu dhe referuar kërimit që është “njohje e faktit juridik...” subjekti i rivlerësimit duhej t’i orientonte palët drejt bazës ligjore të saktë referuar nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile ‘Vërtetimi gjyqësor i fakteve’;
- në dosje mungon akti i përfaqësimit të të paditurit, i cili nuk është fiksuar as në procesverbalin e seancave”, ka dhënë shpjegimet si vijon:

“Në lidhje me konstatimin e bërë nga grupi i punës së KLD-së, theksoj se ky konstatim nuk është i bazuar në dokumentet ligjore pjesë e dosjes gjyqësore mbi bazën e së cilës është kryer dhe vlerësimi profesional dhe është në interpretim të gabuar të ligjit. Kjo për këto arsye:

Grupi i punës së KLD-së nuk i është referuar provave shkresore që janë shqyrtuar dhe administruar gjatë gjykimit, por është bazuar vetëm në formulimin e objektit të kërkesëpadisë nga paditësi i cili ka kërkuar: ‘Njohjen e faktit juridik atë të qenies në marrëdhënie pune me subjektin ish-kooperativa bujqësore Tropojë, fshati ***...’. Ndërsa si bazë ligjore të

kërkesëpadisë paditësi ka vendosur nenin 32 të Kodit të Procedurës Civile i cili përcakton: ‘Padia mund të ngrihet:... (b) për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte; (c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin’.

*Gjatë gjykimit me anën e shpjegimeve të dhëna nga palët ndërgjyqëse dhe pas shqyrtimit të provave të paraqitura nga paditësi rezultoi se dokumentacioni i vjetërsisë në punë, në rastin konkret, ekzistonte. U paraqit si provë në gjykim vërtetimi përkatës me anë të të cilit përcaktohej se: ‘Nga verifikimi i kryer në DAQ e ISSh personi z. K.A.M., nuk figuron në regjistrat e fshatit ***, kooperativa bujqësore Tropojë, rajoni Kukës’. Pra, në rastin konkret, për gjykatën rezultoi e provuar se dokumentacioni i vjetërsisë në punë ekzistonte.*

*Ndodhur në këto rrethana faktike, duke mbajtur parasysh edhe faktin se gjatë gjykimit u shqyrtua si provë edhe vërtetimi nr. *** prot., datë 10.3.2016, i DRSSH-së Tropojë (me të cilin provohet se dokumentacioni i punës ekziston, por emri i paditësit nuk gjendet në regjistër) theksoj se nuk kam qenë në kushtet kur paditësi duhej që të orientohet për t’iu drejtuar gjykatës me një mjet tjetër ligjor procedural, siç është kërkesa e parashikuar nga neni 388 i Kodit të Procedurës Penale (vërtetimi gjyqësor i fakteve).*

Vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin se gjykata e ka gjykuar në mënyrë të drejtë këtë çështje duke identifikuar saktë normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, e cila përputhet me kërkimin e paditësit dhe me bazën ligjore të vendosur prej tij në kërkesëpadi (neni 32/b i Kodit të Procedurës Civile).

Në lidhje me mungesën e aktit të përfaqësimit në dosje i cili nuk është fiksuar në procesverbal sqaroj se të gjitha seancat gjyqësore të zhvilluara për gjykimin e kësaj çështjeje janë fiksuar me procesverbal me regjistrim audio. Pala e paditur ka qenë e përfaqësuar në gjykim me autorizim nga juristi A.B., në të dyja seancat gjyqësore, fakt i cili rezulton i dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio. Konstatohet qartësisht se në rastin konkret nuk ka asnjë dyshim në lidhje me pjesëmarrjen dhe identifikimin e përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur në proces për sa kohë procesverbali është dokumentuar me regjistrim audio.

Në lidhje me sa më sipër me vendimin unifikues nr. 2, datë 27.4.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, është arritur në përfundimin se: ‘... Kolegjet e Bashkuara çmojnë të vlerësojnë se regjistrimet dixhitale audio apo audiovideo përmbushin kriteret dhe karakteristikat që duhet të ketë një mjet teknik i aftë dhe në gjendje për dokumentimin e veprimeve. Kriteret, të cilat çmohet të jenë: besueshmëria, siguria, autenticiteti dhe integriteti i të dhënave, si dhe identifikimi i qartë i pjesëmarrësve dhe përpiluesit të procesverbalit.... ... mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv është jo vetëm në përputhje me nenin 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, por duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit, rrit efektivitetin, eficiencën dhe garanton transparencën në seancat gjyqësore duke përmbushur në mënyrë shteruese dhe autonome funksionin dokumentues të veprimeve procedurale’”.

Nga hetimi i dosjes gjyqësore, duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i vlerësoi të mjaftueshme duke

mos konstatuar problematika thelbësore që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit për kriterin profesional.

Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Erjon Çela është paraqitur vetëm një ankesë në Inspektoratin e KLD-së në vitin 2016. Kjo ankesë, pas verifikimit, i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim etiko-profesional, pasi është konstatuar tejkalim i afatit standard në gjykimin e çështjes.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Erjon Çela përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

DENONCIME

Ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Çela, janë depozituar tri denoncime nga publiku.

1. Denoncim nr. * prot., datë 18.12.2017, i shtetas S.B.**

Shtetasja S.B., ka paraqitur ankesë në lidhje me diskriminimin e bërë ndaj saj nga veprimet e 5 gjyqtarëve në 3 gjykata të ndryshme, përfshirë edhe subjektin Erjon Çela, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Denoncuesja pretendon se nga gjyqtari Erjon Çela, në disa seanca, është lënë në cilësinë e dëgjuesit, duke e nxjerrë jashtë kur pyeste dëshmitarët e thirrur për të dëshmuar. Gjyqtarit Erjon Çela i ka dërguar me shërbimin postar të gjitha provat e ekspertuara nga policia shkencore dhe kishin rezultuar të falsifikuara, si dhe i ka kërkuar rikthimin e çështjes për hetim me objekt riekspertimin e të gjitha provave të tjera që nuk ishin çuar nga prokuroria për ekspertim shkencor dhe kishin lidhje themelore me veprën penale që ishte në gjykim. Gjyqtari Erjon Çela të njëjtat prova që denoncuesja i kishte çuar nëpërmjet postës ia ka rikthyer mbrapsht, duke mos ia pranuar dhe më 4.4.2017 gjyqtari u jep katër të pandehurve pafajësi.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga denoncuesja S.B., rezulton se në vitin 2013 ka lidhur kontratën individuale të punës me AKU-në me detyrën e Inspektore në Drejtorinë Rajonale Kukës. Komisioni i disiplinës e ka thirrur denoncuesen në një seancë dëgjimore në lidhje me një sërë problematikash që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrës nga denoncuesja.

Komisioni i disiplinës i ka klasifikuar këto problematika me pasoja të rënda për institucionin dhe në përfundim ka vendosur masën disiplinore “largim nga shërbimi civil” dhe në datën 24.11.2014 nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së lëshohet urdhri për “zgjidhjen e menjëhershme të kontratës individuale të punës”.

Për këtë arsye, denoncuesja S.B., i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt “shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ nr. ***, datë 21.11.2014, të Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU)” si akt i pabazuar në prova dhe ligj dhe rikthimin në detyrën e mëparshme të paditëses, si dhe pagimin e pagës nga data 24.11.2014 deri në momentin e kthimit në detyrë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2015, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditëses S.B.”*.

Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin e datës 23.3.2017 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 23.3.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”*.

Në vitin 2014 shtetasja S. B. ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ndaj shtetasve A.Z., S.R., F.I., dhe H.D., për veprën penale “falsifikim i dokumenteve shtetërorë”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka shpallur moskompetencën tokësore për procedimin penal nr. ***, të vitit 2014.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2016 në ngarkim të të pandehurve A.Z., S.R., F.I., dhe H.D.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, pas përfundimit të hetimeve, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. ***, të vitit 2016 në ngarkim të të pandehurve A.Z., S.R., F.I., dhe H.D., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim i dokumenteve në bashkëpunim” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin e datës 4.4.2017 (dhënë nga subjekti Erjon Çela), ka vendosur: *“Deklaramin e pafajshëm të të pandehurve A.Z., S.R., F.I., dhe H.D., për kryerjen e veprës penale ‘falsifikim i dokumenteve’ e parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, pasi nuk provohet që të pandehurit e kanë kryer veprën penale që akuzohen.”*

Në datën 24.4.2017 denoncuesja S.B., ka dërguar në KLD ankesën ndaj gjyqtarëve A.H., dhe Erjon Çela për mosrespektim formal të ligjit.

KLD-ja (Inspektorati), me shkresën e datës 31.8.2017, i ka përcjellë denoncueses S.B., përgjigjen se ankesa e saj nuk përmbush kriterin e bazueshmërisë për pranueshmëri sipas parashikimeve të nenit 120/1/c të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë kohës që ka qenë në gjykim çështja penale në ngarkim të 4 të pandehurve, shtetasja S.B., në datën 10.1.2017 i ka dërguar gjyqtarit Erjon Çela disa prova shkresore që sipas pretendimit të saj duhet të konsiderohen si pjesë të hetimit.

Gjyqtari Erjon Çela, me shkresën e datës 18.1.2017, i ka kthyer përgjigje duke i kthyer dokumentacionin e depozituar prej saj, pasi gjykata me vendim të ndërmjetëm të seancës së datës 10.1.2017 vendosi që të mos e pranojë këtë kërkesë të ankueses, pasi nuk rezulton që ajo të ketë qenë palë në këtë gjykim dhe, rrjedhimisht, nuk ka të drejtën që të japë sqarime apo shpjegime plotësuese dhe as të paraqesë prova në gjykim. Komisioni vëren se:

- Në lidhje me pretendimin e denoncueses për sa i përket kthimit të dokumentacionit nga subjekti Erjon Çela, referuar përgjigjes së datës 18.1.2017, ai i ka dhënë sqarimet e duhura denoncueses duke argumentuar dhe arsyen e kthimit të dokumentacionit të dërguar prej saj.
- Për sa i përket vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Çela, ka analizuar provat e paraqitura nga Prokuroria (provat shkresore, aktekspertimin, provën me dëshmitarë, etj.), ka marrë për referencë dhe vendime të gjykatave më të larta dhe pas analizimit të tyre ka arritur në përfundimin se nga ana e të pandehurve nuk provohet ekzistenca e të gjithë

elementëve përbërës të figurës së veprës penale “falsifikim i dokumenteve” e parashikuar nga neni 186/2 të cilët janë objekti. Ana objektive, subjekti dhe ana subjektive.

Nga hetimi i dosjes gjyqësore, duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues nuk konstatoi problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit për kriterin profesional.

2. Denoncim nr. * prot., datë 4.12.2018, i shtetasit A.J.**

Shtetasi A.J., ka denoncuar 15 subjekte rivlerësimi (gjyqtarë dhe prokurorë) duke përfshirë edhe subjektin Erjon Çela, pasi sipas denoncuesit ai ka marrë vendim⁴² me ndikim të njëanshëm për faktin se nuk janë hetuar asnjë nga kallëzimet e denoncuesit me aktet shkresore dhe siç është shprehur subjekti në vendimin e tij nr. ***, datë 2.10.2018.

Denoncuesi A.J., ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës (procedimi penal nr. *** i vitit 2013) për veprën penale “shpërdorim të detyrës” ndaj shtetasve A.L., D.G., etj., anëtarë të ish-Këshillit Bashkiak Krumë, të cilët me vendimmarrjen e tyre i kanë bllokuar një rrugë kalimi për të shkuar në banesën e tij si dhe kanalën ujitës dhe pretendon se AMTP-ja e vitit 1993 është e falsifikuar.

Pas disa proceseve hetimore dhe gjyqësore të kryera më parë⁴³, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës ka kryer veprimet hetimore sipas detyrave të lëna në vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, duke u kryer aktekspertimi nga dy ekspertë të licensuar, si dhe duke u bërë ballafaqimi mes shtetasit A.J., dhe shtetasve A.L., D.G., etj., nisur nga dyshimet për përdorim të dokumenteve të falsifikuara dhe konkretisht AMTP-së dhënë nga komisioni i ndarjes së tokës⁴⁴. Nga kallëzuesi A.J., nuk u paraqit asnjë provë për të provuar pronësinë e kësaj sipërfaqeje toke si pronar apo si person që gëzon një të drejtë reale ose posedim të saj me gjithë pretendimet e tij.

Organi i akuzës ka konkluduar se: *“Në rastin konkret nuk rezulton e provuar vepra penale e shpërdorimit të detyrës nga ish-anëtarët e këshillit bashkiak, ndërsa në lidhje me AMTP-në jemi përpara veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, por kjo vepër penale është parashkruar dhe, për këtë arsye, ky procedim penal duhet të pushohet.”*

Nga Gjykata (vendimi i dhënë nga subjekti Erjon Çela), në analizë të provave shkresore të administruara nga gjykata, të paraqitura nga palët, çmohet se fakti penal për të cilin janë kryer hetimet nuk ekziston. Gjykata arrin në përfundimin se vepra penale e shpërdorimit të detyrës nuk ekziston, si dhe vepra penale e falsifikimit të dokumenteve është parashkruar pasi kanë kaluar

⁴²Vendim nr. ***, datë 2.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

⁴³ Organi i prokurorisë datë 12.10.2010 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***. Vendimi i Prokurorisë është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës nga ana e kallëzuesve.

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. ***, datë 13.6.2011, ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës së kërkuarve duke e lënë në fuqi vendimin e prokurorisë së datës 12.10.2010 për mosfillimin e procedimit penal.

*Ky vendim është ankimuar nga z. A.J., në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr. ***, datë 29.4.2013 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 13.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, duke e prishur vendimin e mosfillimit të datës 12.10.2010 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe kthimin e akteve për vazhdimin e veprimeve të mëtejshme hetimore”.

*Organi i akuzës, pasi ka kryer veprimet përkatëse hetimore, ka disponuar përsëri me pushimin e çështjes penale.

*Ky vendim pushimi përsëri është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, e cila me vendimin e saj ka kërkuar nga Prokuroria të kryhen veprimet e lëna detyrë nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 29.4.2013, që konsistojnë në ballafaqimin mes kallëzuesit A.J., dhe të kallëzuarve, si dhe kryerjen e ekspertimit inxhinierik topografik në grup.

⁴⁴ Sipas aktekspertimit, dokumenti AMTP i vitit 1993 rezulton se nuk është në formën e duhur dhe sipas organit të akuzës mund të jemi përpara veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, por jemi dhe para faktit të parashkrimit të ndjekjes penale, pasi bazuar në nenin 66 të Kodit Penal kanë kaluar më shumë se 10 vjet për këtë veprër penale.

mbi 10 vjet dhe, në përfundim, vendosi: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Kukës. Pushimin e procedimit penal nr. 208 i vitit 2013 për veprën penale ‘shpërdorim të detyrës’ parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për shkak se fakti penal nuk ekziston”.

Komisioni vëren se problematikat që ngre denoncuesi ndaj 15 subjekteve, duke përfshirë edhe subjektin Erjon Çela, lidhen me mosdakordësinë e denoncuesit me vendimet e marra nga subjektet. Këto janë problematika të natyrës që zgjidhen nga gjykatat më të larta pasi kanë të bëjnë me themelin e çështjes për të cilin Komisioni mban parasysh nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Denoncim nr. * prot., datë 7.6.2019, i shtetasit Z.B.**

Shtetasi Z.B., ka denoncuar subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Çela, pasi ka dhënë një vendim të padrejtë “arrest me burg”, në shkelje me ligjin, pa asnjë provë, vetëm duke u bazuar në hamendësime dhe në një video të paligjshme brenda territorit të tij, pa asnjë të drejtë duke cenuar privatësinë e këtij shtetasi.

Komisioni vëren se denoncuesi nuk i ka bashkëngjitur asnjë dokument denoncimit të tij dhe, gjithashtu, në denoncim nuk ka referuar asnjë vendim në mënyrë që të bëhet analiza dhe evidentimi nëse ka shkelje të karakterit procedural apo jo.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues i Komisionit

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Çela:

a. ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe të saktë të pasurisë;

Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi tij dhe i personit të lidhur me të, si dhe huat ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të blerë pasuritë, për të krijuar likuiditetet dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e jetesës të evidentuara gjatë periudhës së rivlerësimit 2011 – 2016, vetëm në vitin 2016, në shumën -141,133 lekë, të cilën Komisioni, në bazë të parimit të proporcionalitetit, e vlerëson si të papërfillshme duke mos prodhuar pasoja të tilla, që mund të çojnë në konkluzionin se ndodhet përpara një deklarimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

Mosdeklarimi i kredisë prej 520,000 lekë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, por deklarimi i saj në deklaratat e viteve 2014 dhe 2015, e shoqëruar dhe me konfirmimin e kësaj kredie nga dokumentet bankare, përbën një pasaktësi të karakterit minimal të rregulluar në deklaramin e radhës që nuk plotëson elementet e nevojshëm për t’u konsideruar si shkak që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016 dhe, si i tillë, nuk duhet të përdoret si shkak/konkluzion mbi të cilin mund të mbështet një vendimmarrje për shkarkimin e subjektit nga detyra.

- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Erjon Çela, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nga vlerësimi i secilit të të tri kriterëve:

- a. ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “a” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit nr. 84/2016;
- c. konsiderohet “i aftë” në vlerësimin e aftësive profesionale, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të pikës 1/a të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Çela, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 2.10.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj